

QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN

Parandalimi i Dhunës Seksuale dhe Dhunës me Bazë Gjinore nëpërmjet avokimit, edukimit dhe promovimit të barazisë gjinore si një e drejtë njerëzore

PROFILI I VENDIT



Popullsia
(UNFPA 2019)

2.9m



Përvoja e dhunës së grave dhe vajzave gjatë jetës
(UNDP 2019)

52.9%



Dhuna nga partneri intim, gratë
(OSCE 2019)

19%



Indeksi I pabarazisë gjinore
(UNDP 2019)

51st

PUNA E QSHPZH-SË PËR GJININË DHE DHSBGJ

Dhuna seksuale dhe me bazë gjinore është një fenomen i rrënjësor thellë në pabarazinë gjinore dhe vazhdon të jetë një nga shkeljet më të dukshme të të drejtave të njeriut. Dhuna seksuale dhe me bazë gjinore është e përhapur në Shqipëri dhe shumë raste mbeten të nënraportuara për shkak të frikës dhe stigmës. Edhe pse shteti ka krijuar mekanizma për të mbrojtur dhe ndihmuar të mbijetuarit, këta mekanizma mbeten të dobët në nivele lokal dhe shpesh joefektivë.

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin punon në të gjithë Shqipërinë dhe në forume rajonale dhe ndërkombëtare për të avokuar për një legjislacion dhe politikë të fortë kundër dhunës seksuale dhe me bazë gjinore dhe për të promovuar barazinë gjinore. Ne punojmë me komunitetet lokale për të siguruar shërbime dhe për të mundësuar që anëtarët e komunitetit të kenë njohuri dhe mjete për të kërkuar të drejtat.

E themeluar në vitin 1993, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin u bë anëtare e IPPF (Federata Ndërkombëtare e Planifikimit Familjar) në 1996. Në një kontekst në të cilin mbështetja shtetërore e shërbimeve të specializuara për gratë është e pamjaftueshme, ne mbetemi në krye të rritjes së ndërgjegjësimit, ofrimit të edukimit seksual gjithëpërfshirës dhe avokimit për të parandaluar dhunën seksuale dhe me bazë gjinore dhe për të arritur barazinë gjinore.

Plani ynë Strategjik

AVOKACI

- Ne avokojmë për legjislacion për të parandaluar dhunën seksuale dhe me bazë gjinore dhe për të rritur ndërgjegjësimin në komunitet

EDUKIMI SEKSUAL GIJHPERFSHIRE

- Ne punojmë për të siguruar që mësuesit janë të trajnuar siç duhet për të ofruar edukimin seksual dhe që studentët të marrin edukimin seksual gjithëpërfshirës .

SHERBIME

- Ne ofrojmë shërbime për komunitetet në nevojë, duke përfshirë shërbime të specializuara të shëndetit seksual dhe riprodhues dhe shërbime psikosociale.

QEVERISJE E MIRE

- Angazhimi ynë për barazinë gjinore reflektohet në strukturën tonë me një politikë të brendshme të barazisë gjinore dhe një përbërje bordi prej 50% gra.

QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN

Parandalimi i Dhunës Seksuale dhe Dhunës me Bazë Gjinore nëpërmjet avokimit, edukimit dhe promovimit të barazisë gjinore si një e drejtë njerëzore

PUNA JONË PËR PARANDALIMIN DHE DREJT BARAZISË GJINORE

SHERBIME

- 422 shërbime të lidhura me dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore të ofruara, 2018.
- 350 ofrues shërbimesh të trajnuar nga Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin për parandalimin dhe depistimin e dhunës tek gratë dhe vajzat.

EDUKIM

- 1000 mësues të trajnuar dhe 1500 studentë të udhëzuar me kurrikulën tonë për edukimin seksual gjithëpërfshirës (ESGJ).
- Rritje 400% të raportimeve për shkelje të të drejtave falë programit të ESGJ të organizatës, 2008-2019.

TRAJNIM

- 154 gra politikanë të trajnuara për çështjet gjinore, 2014-2016.
- 260 vendim-marrës të trajnuar për buxhetimin gjinor, 2014-2016.

Përmes ofrimit të shërbimeve dhe trajnimit, ne synojmë të demostrojmë rëndësinë e barazisë gjinore në parandalimin e dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut:

- Ne ofrojmë shërbime të lidhura me dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore për komunitetet në nevojë përmes dy klinikave tona. Ofruesit tanë të shërbimit sigurojnë që të gjithë ata që vijnë të marrin shërbimet shëndetësore dhe psikosociale që u duhen.
- Programi ynë i edukimit seksual gjithëpërfshirës është zbatuar për moshat 10-19 vjeç. Nga viti 2008-2019 ka patur një rritje prej 400% të të rinjve, grave dhe vajzave që raportojnë shkelje të të drejtave dhe dhunë seksuale dhe me bazë gjinore si rezultat i promovimit të sistemit të raportimit; dhe zvogëlimit të barrierave për raportim.
- Për të siguruar që barazia gjinore të jetë në axhendën politike dhe sociale, ne trajnojmë politikanë dhe vendim-marrës për çështjet gjinore dhe se si t'i përfshijnë këto çështje në programet për të arritur barazinë gjinore.

AKTIVIZËM DHE AVOKACI

Rritja e ndërgjegjësimit në komunitet

- Programet tona inovative për ngritjen e vetëdijes përfshijnë përdorimin e teatrit për të edukuar komunitetet për barazinë gjinore.
- Ekipet tona të veprimit të bazuara në komunitet (combat), të përbëra kryesisht nga djem iniciojnë fushata që sfidojnë normat shoqërore të lidhura me gjininë.

Avokimi për mbështetje të forcuar të shtetit

- Përpjekjet për avokim të Organizatave të Shoqërisë Civile, përfshirë QSHPZH-në sollën miratimin (ligji 47/2018 i ndryshuar datë 23.07.2018) e ndryshimeve të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, për "Masat kundërdhunës në marrëdhëniet familjare".
- Ne krijuam forumet e pavarura të grave, të cilat sollën financimin nga pushteti vendor të kurseve profesionale falas përfshirë koston e transportit për gratë dhe vajzat e mbijetuara të dhunës.
- Kontributi ynë në proceset e Kombeve të Bashkuara ka cuar në përmisimin e rregullave dhe procedurave për të mbrojtur të mbijetuarit e dhunës në familje.



Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin është një organizatë jo fitimprurëse që punon për përmirësimin e politikave, legjisllacionit, qasjen në informacion dhe shërbime në çështje që prekin popullatën dhe zhvillimin, përfshirë shëndetin riprodhues.

Ne jemi për riprodhimin e lirë, drejtësinë, dhe autonominë për gratë, burrat, dhe familjet!